



British Embassy
Pristina

Doracak mbi Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (Paditë SLAPP)

Për profesionistët e drejtësisë:
gjykatës, prokurorë, avokatë, policë dhe
akterë të tjerë të sistemit të drejtësisë



Doracak mbi paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (Paditë SLAPP)

**Për profesionistët e drejtësisë:
gjykatës, prokurorë, avokatë, policë dhe
akterë të tjerë të sistemit të drejtësisë**

TITULLI:

**Doracak mbi Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike
(Paditë SLAPP)**

Për profesionistët e drejtësisë: gjykatës, prokurorë, avokatë, policë
dhe akterë të tjerë të sistemit të drejtësisë

AUTORE:

Flutura Kusari
Reze Hoxha Zhuj

EDITOR

Chemonics UK

VITI I BOTIMIT:

2025

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Pilot Projekti SLAPP për Kosovë (Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike) është i mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë dhe zbatohet nga Chemonics UK. Ky doracak synon që të ngris vetëdijen e palëve të ndryshme, si gjykatës, prokurorë, avokatë, policë dhe profesionistë të tjerë ligjorë, për të kuptuar se si përdoren SLAPP dhe si të merren masa kundër tyre.

Publikimi i këtij doracaku mbështetet nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Prishtinë në kuadër të Pilot Projekti SLAPP për Kosovë. Opinionet dhe rekomandimet në këtë doracak janë përgjegjësi ekskluzive e Chemonics UK, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Hyrje	7
3. Çfarë janë paditë SLAPP dhe cili është qëllimi i tyre?	8
Çfarë janë paditë SLAPP?	8
Cili është qëllimi i padive SLAPP?	8
Cilat janë llojet e padive SLAPP?	9
Kush parashtron paditë SLAPP?	10
Ndaj kujt parashtronen paditë SLAPP?	11
Si mund të identifikohen paditë SLAPP?	12
Cilat janë efektet e padive SLAPP?	14
4. Çfarë mund të bëjnë gjykatat, prokuroritë dhe organet administrative për luftimin e padive SLAPP?	15
5. Përfundim	17

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky doracak trajton *Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike* (SLAPP), që janë veprime ligjore të përdorura për të frikësuar, penguar ose dekurajuar individët që angazhohen në çështje të interesit publik. Ky lloj i padive është i njohur për përdorimin abuziv të sistemit gjyqësor, dhe është një mjet për të frikësuar gazetarët, aktivistët, ose individë të tjerë që shprehin kritika ndaj pushtetit ose interesave të fuqishme. Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për autoritetet ligjore dhe aktorët e tjerë relevantë në identifikimin dhe luftimin e këtyre praktikave.

Ky dokument analizon origjinën dhe zhvillimin e padive SLAPP, ndikimin e këtyre padive në Evropë dhe gjithashtu përfshin informacion rreth legjislacionit ndërkombëtar, përfshirë Rekomandimin CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) dhe Direktivën (BE) 2024/1069 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 prill 2024 për mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrje publike nga pretendimet qartësisht të pabazuara ose nga procedurat gjyqësore abuzive (Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike”).

Një fokus i veçantë është përpjekja për të rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet që paraqesin paditë SLAPP për lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen publike, duke inkurajuar autoritetet të reagojnë efektivisht ndaj këtyre veprimeve që mund të pengojnë demokracinë dhe transparencën.

Dokumenti ofron gjithashtu një përshkrim të llojeve të ndryshme të padive SLAPP, duke përfshirë paditë vendore, ndërkufitare, dhe ato të shumëfishta, dhe tregon se cilët akterë janë më së shpeshti autorë të këtyre padive, si figura publike, politikanë, dhe kompani të mëdha.

Në këtë kontekst, qëllimi i udhëzuesit është të ndihmojë autoritetet, gjykatat, prokuroritë dhe profesionistët ligjorë të njohin dhe të luftojnë paditë SLAPP në përputhje me angazhimet ndërkombëtare, duke mbrojtur të drejtën e individëve për të marrë pjesë në debatin publik pa frikë nga ndëshkimi ose kërcënimi.

2. Hyrje

Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike, të njohura si paditë SLAPP (nga gjuha angleze "Strategic Lawsuit Against Public Participation"), janë veprime ligjore të cilat synojnë të dekurajojnë pjesëmarrjen publike dhe të pengojnë ose frikësojnë targetin e tyre. Termi paditë "SLAPP" është përdorur për herë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitet tetëdhjeta, por origjina e përdorimit të tij mund të gjurmohet edhe në diskutime dhe raste gjyqësore të mëparshme.

Në Europë, përdorimi i termit SLAPP u shpeshua në mes të vitit 2017 dhe 2018 dhe është ngushtë i lidhur me gazetaren hulmuese malteze Daphne Caruana Galizia, e cila u vra brutalisht me një bombë të vendosur në veturën e saj.¹ Në momentin e vrasjes së saj, ajo kishte 47 padi aktive për shpifje ndaj saj.

Që nga ajo kohë, në Europë kanë ndodhur një sërë veprimesh të ndërmarra nga ana e organizatave ndërkombëtare të shoqërisë civile dhe institucioneve europiane që kanë kulmuar me aprovimin e Direktivës së Bashkimit Evropian kundër padive SLAPP dhe Rekomandimin e Këshillit të Evropës kundër padive SLAPP.

Qëllimi i këtij doracaku është të ofrojë informacione rreth padive SLAPP dhe të ofrojë udhëzime që mund të ndihmojnë gjykatat, prokuroritë dhe profesionistët tjerë ligjorë në identifikimin dhe luftimin e veprimeve ligjore strategjike kundër pjesëmarrjes publike. Doracaku poashtu synon të rrisë ndërgjegjësimin për rrezikun që paraqesin paditë SLAPP, ashtu që autoritetet t'i përgjigjen në mënyrë efektive këtyre praktikave abuzive, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes publike.

Ky material është mbështetur në Rekomandimin i KiE-së kundër Padive SLAPP dhe Direktivën e BE-së kundër padive SLAPP për mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrje publike nga pretendimet qartësisht të pabazuara ose nga procedurat gjyqësore abuzive.

¹ Përdorimi i terminit SLAPP edhe në gjuhën shqipe është i rëndësishëm për shkak të përdorimit të tij ndërkombëtar, mungesës së një përkthimi të plotë dhe të saktë që ruan nuancat e konceptit, si dhe për t'u mundësuar profesionistëve dhe institucioneve të kuptojnë dhe komunikojnë në mënyrë të njëjtë për këtë fenomen ligjor.

3. Çfarë janë paditë SLAPP dhe cili është qëllimi i tyre?

Çfarë janë paditë SLAPP?

Përkthimi i "Strategic Lawsuits Against Public Participation" në gjuhën shqipe është "Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike", mirëpo, Këshilli i Evropës në rekomandimin e tij kundër padive SLAPP përmend termin "veprime ligjore" në mënyrë që rastet SLAPP të mos kufizohen vetëm në ato të natyrës civile por të përfshijnë edhe rastet penale dhe administrative.

Rekomandimi i KiE-së kundër Padive SLAPP, përcakton që veprimet ligjore strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) kuptohen si *veprime ligjore që kërcënohen, iniciohen ose përdoren si një mjet për të ngacmuar ose frikësuar objektivin e tyre, dhe që synojnë të parandalojnë, kufizojnë, pengojnë ose ndëshkojnë shprehjen e lirë në çështje të interesit publik dhe ushtrimin e të drejtave të lidhura me pjesëmarrjen publike.*

Me padi SLAPP nënkuptohen paditë civile, kallëzimet penale ose hetime ex officio dhe procedurat dhe vendimet administrative që mund të kenë ndikim në pjesëmarrjen publike.

Rekomandimi i KiE-së kundër Padive SLAPP nuk mbulon vetëm situatat kur ushtrohet një padi civile apo kallëzim penal por edhe veprimet ligjore që mund t'i'u paraprijnë padive SLAPP, siç janë përshtetshëm letrat ligjore që avokatët ua dërgojnë gazetarëve dhe aktivistëve duke i kërcënuar me padi dhe kërkesa për dëmshpërblim nëse ata raportojnë apo ngrisin zërin për një çështje të caktuar.

Cili është qëllimi i padive SLAPP?

Paditë SLAPP synojnë të abuzojnë me procesin ligjor për të parandaluar, penguar, kufizuar ose penalizuar shprehjen e lirë për çështjet e interesit publik dhe ushtrimin e të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike.

Paditësit me këto veprime kanë për qëllim heshtjen e kritikëve dhe frikësimin e tyre përmes presionit ligjor dhe shpenzimeve të larta. Në shumicën e rasteve, paditësit nuk presin të fitojnë çështjen në gjykatë, por synojnë që të paditurit të lodhen financiarisht dhe psikologjikisht, duke i detyruar të heqin dorë nga pjesëmarrja e tyre në çështje publike.

Pra qëllimi i paditësve mund të përmblihet në këto pika: heshtja e atyre që guxojnë të kritikojnë publikisht për çështjet e interesit publik; frikësimi i të paditurve; censurimi; si dhe shkatërrimi i reputacionit të të paditurve.

Për më tepër, për të kuptuar qartë qëllimin e padive SLAPP është e rëndësishme të kuptohen drejtë definimet e dhëna në Rekomandimin i KiE-së kundër Padive SLAPP për termat e mësipërm:

- ▶ **Pjesëmarrja publike:** E drejta e secilit për të marrë pjesë në debatin publik dhe çështjet publike, online dhe offline, pa frikë apo diskriminim, përfshirë të drejtën për të shprehur mendime dhe ide që bien ndesh ose janë kritike ndaj atyre që mbrohen nga autoritetet zyrtare ose nga një pjesë e konsiderueshme e opinionit publik, ose që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Fushëveprimi i termit mbulon gjithashtu veprimet që përgatitin, mbështesin ose ndihmojnë pjesëmarrjen publike.
- ▶ **Interesi publik:** Të gjitha çështjet që prekin publikun dhe në të cilat publiku mund të ketë interes legjitim, veçanërisht ato çështje që kanë të bëjnë me çështje sociale ose që ndikojnë në mirëqenien e individëve ose jetën e komunitetit ose mjedisit. Interesi publik shtrihet në çështje që mund të shkaktojnë polemika të konsiderueshme, por jo në informacion në lidhje me jetën private të të tjerëve, ose në dëshirën e audiencës për lajme të bujshme dhe emocionale. Temat mund të jenë me interes publik në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar.

Andaj, paditë të cilat kanë për qëllim censurimin e pjesëmarrjes publike dhe kufizimin e shprehjes së lirë për çështjet e interesit publik duhet kuptuar si padi SLAPP.

Cilat janë llojet e padive SLAPP?

Bazuar në Rekomandimin e KiE-së kundër Padive SLAPP, format/llojet specifike të padive SLAPP përfshijnë:

- ▶ **Paditë SLAPP vendore:** Padi të ngritura brenda juridiksionit vendor, zakonisht nga akterë të fuqishëm kundër gazetarëve, aktivistëve, organizatave të shoqërisë civile ose qytetarëve të angazhuar në çështje publike. Këto padi synojnë të heshtin kritikën, të frikësojnë të paditurit dhe të pengojnë pjesëmarrjen publike.
- ▶ **Paditë SLAPP ndërkufitare:** Padi të ngritura në një apo më shumë juridiksione të huaja për të ushtruar presion mbi individë ose organizata në një vend tjetër. Këto lloj padish shfrytëzojnë dallimet ligjore midis vendeve dhe shpesh përdorin juridiksione ku ligjet janë më të favorshme për paditësin dhe më kufizuese për lirinë e shprehjes.
- ▶ **Paditë SLAPP të shumëfishta ose të koordinuara:** Padi të shumta të ngritura njëkohësisht ose në mënyrë të sinkronizuar kundër të njëjtit individ ose organizatë, me qëllim të rritjes së barrës financiare dhe psikologjike. Këto padi mund të jenë të ndryshme në natyrë (për shembull, padi për shpifje, dëmtim të reputacionit, shkelje të privatësisë, publikim të të dhënave personale), por të gjitha kanë të njëjtin qëllim: të pengojnë aktivitetin e personit apo organizatës që synohet.
- ▶ **Paditë SLAPP kundër pjesëmarrjes anonime të publikut:** Padi të drejtuara ndaj personave që kontribuojnë në diskutime publike në mënyrë anonime, duke synuar zbulimin e identitetit të tyre dhe frikësimin e mëtejshëm. Këto padi zakonisht parashtrohen ndaj përdoruesve të rrjeteve sociale apo platformave të tjera online ku personat në mënyrë anonime shprehin mendime kritike.

Këto forma të SLAPP-ve përdoren gjerësisht nga akterë të fuqishëm për të kufizuar hapësirën demokratike dhe për të ndaluar kritikën ndaj interesave të tyre, duke penguar lirinë e shprehjes dhe transparencën në shoqëri.

Kush parashtron paditë SLAPP?

Ashtu siç u përmend më lartë, SLAPP mund të paraqiten në forma të ndryshme si veprime ligjore civile (padi), veprime ligjore bazuar në të drejtën administrative si dhe veprime penale (kallëzime penale ose hetime ex officio). Të njejtat janë mjete që përdoren si formë e ushtrimit të presionit ndaj të gjithë mbikëqyrësve publikë (aktivistëve), gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, etj., duke ndikuar drejtpërdrejt në kufizimin e lirisë së shprehjes. Për më tepër, gratë dhe personat me orientim të ndryshëm seksual, identitet gjinor, shprehje gjinore ose karakteristika fizike seksuale përballen me rreziqe të veçanta në kapacitetin e tyre si gazetarë, mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrës të tjerë publikë, kur targetohen nga SLAPP. Në shumë raste, këto grupe përballen jo vetëm me padi SLAPP, por edhe me sulme të orkestruara në rrjete sociale, ngacmime dixhitale dhe kërcënime me bazë gjinore. Përdorimi i ligjit për të censuruar dhe frikësuar zërat e këtyre grupeve forcon normat ekzistuese të pabarazisë dhe dobëson aftësinë e tyre për të marrë pjesë në debatin publik.

Këto padi parashtrohen nga individë me pushtet, të cilët synojnë të heshtin kritikët dhe të shmangin mbikëqyrjen publike. Më poshtë ofrohet një listë joshteruese e subjekteve që në shumicën e rasteve parashtojnë paditë SLAPP:



Figura publike dhe politikanë – Zyrtarë të lartë që synojnë të mbrojnë imazhin e tyre duke heshtur zërat kritikë.



Sipërmarrës të fuqishëm dhe kompani të mëdha – Korporata të fuqishme, kompani të përfshira në tenderë publikë apo sipërmarrës që synojnë të ndalojnë raportimet për aktivitetet e tyre të dyshimta.



Institucione shtetërore dhe publike – Agjenci qeveritare, ndërmarrje publike apo organe shtetërore që përdorin paditë për të shmangur mbikëqyrjen dhe llogaridhënien.



Individë të fuqishëm në sektorë të ndryshëm – Individë të lidhur me pushtetin dhe figura të tjera me ndikim.

Ndaj kujt parashtrihen paditë SLAPP?

Paditë SLAPP, që shpesh shenjtërojnë individë dhe organizata që angazhohen në çështje të interesit publik, parashtrihen ndaj atyre që kanë guximin të sfidojnë pushtetin dhe të kërkojnë transparencë. Këto padi parashtrihen kryesisht ndaj:



Gazetarëve dhe mediave që ekspozojnë korrupsionin, keqpërdorimin e parave publike ose keq menaxhimin.



Aktivistëve të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes dhe transparencën institucionale.



Qytetarëve të angazhuar që denoncojnë publikisht shkeljet, nënshkruajnë peticione, organizojnë protesta apo shpërndajnë informacione për çështje me interes publik.



Avokatëve të të drejtave të njeriut që mbrojnë viktimat e abuzimeve apo angazhohen në çështje të barazisë dhe drejtësisë sociale.



Hulumtuesve dhe studiuesve që publikojnë analiza dhe studime kritike.



Grave, grupeve minoritare dhe personave të tjerë të marginalizuar për të kufizuar aktivizmin e tyre në çështjet e interesit publik dhe për t'i frikësuar nga pjesëmarrja në debatet sociale. Paditë SLAPP përdoren gjithashtu për të heshtur në mënyrë të veçantë gratë aktiviste dhe gazetaret, të cilat përballen jo vetëm me sfidat ligjore, por edhe me sulme të dyfishta, duke përfshirë kërcënime gjinore dhe dhunë dixhitale.



Avokatëve që mbrojnë të drejtat e grave dhe minoriteteve duke synuar të ndalojnë përpjekjet e tyre për të mbrojtur grupet e cenushme.

Me fjalë të tjera, nëse një qytetar/e (gazetar/e, aktivist/e, etj.) ankohet publikisht ndaj veprimeve të ndonjë kompanie apo të ndonjë individi të famshëm e me pushtet, këta të fundit paguajnë avokatë për të ngritur padi në mënyrë që t'i frikësojnë ata, me qëllim që të njejtit të mos vazhdojnë të shprehin publikisht kritikën ndaj aktiviteteve të tyre.

Ndonëse paditësit e dinë mirë se paditë e tyre nuk do të kenë sukses në gjykatë, por duke e ditur se çështjet e tilla kërkojnë vite të tëra që të zgjidhen, e shfrytëzojnë këtë si rrethanë që të mbajnë të paditurit nën kërcënim përmes një procesi gjyqësor që zhvillohet ndaj tyre. Ndërkaq në anën tjetër, qytetarët shpesh nuk i kanë mjetet financiare për tu bërë ballë shpenzimeve për të paguar mbrojtës që denjësisht do t'i përfaqësonin ata në këto procese. Personat që janë cak të padive SLAPP përballen edhe me sfida të tjera financiare si shkas i padive SLAPP, që tejkalojnë nevojat financiare të mbrojtjes ligjore, meqenëse të njejtit përballen edhe me fushata denigruese të cilat ndikojnë në humbjen e vendit të punës në raste të caktuara, humbje të mundësive për zhvillim, etj. Pra efekti ekonomik dhe financiar është shumë i gjerë dhe dëmi që shkaktohet është skajshmërisht i lartë.

Si mund të identifikohen paditë SLAPP?

Paditë SLAPP dallohen nga veprimet e tjera për qëllimin e tyre kryesor, që është ndalimi i pjesëmarrjes publike dhe frikësimi i individëve që angazhohen në çështje të interesit publik. Ato shfrytëzojnë pabarazinë e pushtetit midis palëve, ku kërkuesi ka ndikim financiar ose politik më të madh se i padituri. SLAPP shpesh janë të pabazuara në fakte, kërkojnë dëmshpërblim të lartë ose sanksione të tepërta dhe përdorin taktika të abuzimit për të ngadalësuar proceset gjyqësore. Ato përqendrohen te individët, jo organizatat, dhe shpesh përfshijnë kërcënime dhe intimidim për të frikësuar të paditurit. Dallimi kryesor me veprimet legjitime ligjore është përdorimi i sistemit gjyqësor në mënyrë abuzive për të penguar shprehjen e lirë dhe pjesëmarrjen publike.

Tre elementet fillestare të identifikimit të SLAPP janë:

1

Veprimi ligjor është i drejtuar kundër pjesëmarrjes publike: Veprimi ligjor synon të keqpërdorë ose abuzojë me procesin ligjor për të parandaluar, kufizuar, penguar ose ndëshkuar shprehjen e lirë në çështje të interesit publik dhe ushtrimin e të drejtave të lidhura me pjesëmarrjen publike.

2

Përfshirja e të gjitha pretendimeve ligjore për shkelje të mundshme të ligjit: Paditë SLAPP që përdoren kundër pjesëmarrjes publike përdorin bazë të ndryshme ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në ligjet për shpifje.

2

Të gjitha fazat e veprimit ligjor: Në rastet SLAPP duhet t'iu kushtohet rëndësi të gjitha fazave të veprimit ligjor, përfshirë kërcënimin fillestar për padi SLAPP, i cili në vetvete mund të ketë një efekt frenues në pjesëmarrjen publike.

Këshilli i Evropës, në Rekomandimin kundër Padive SLAPP, përcakton një listë treguesish që shërbejnë si mjete për identifikimin e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) dhe dallimin e tyre nga veprimet e tjera të rregullta ligjore. Këta tregues janë shumë të rëndësishëm, pasi ata ndihmojnë në zbardhjen e natyrës abuzive të SLAPP. Kjo listë është një mjet i dobishëm për autoritetet ligjore dhe shoqërinë për të identifikuar dhe parandaluar përdorimin e këtij tipi të padive për të kufizuar lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen publike, duke mbrojtur kështu demokratizimin dhe mbajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të hapur për diskutime dhe angazhime publike.

Treguesit² përfshijnë, por nuk kufizohen në elementet e mëposhtëm:

- ▶ **Shfrytëzimi i pushtetit:** Paditësi përdor pushtetin financiar, politik apo shoqëror për të ushtuar presion mbi të paditurin;
- ▶ **Argumente të pabazuara:** Paditësi në padi paraqet argumente që nuk janë të mbështetura në fakte;
- ▶ **Kërkesa të tepruara:** Paditësi kërkon dënime joproporcionale, të paarsyeshme dhe të padrejta për të rënduar të paditurin;
- ▶ **Abuzimi me ligjet/procedurat gjyqësore:** Paditësi kërkon që përmes ligjit dhe procedurave gjyqësore të arrihen qëllime të paligjshme, e jo të vendoset drejtësi;
- ▶ **Taktika për të rritur shpenzimet:** Paditësi përdor vonesa dhe manovra ligjore për ta bërë procesin sa më të gjatë dhe të shtrenjtë për të paditurin;
- ▶ **Sulm ndaj individëve:** Paditësi shpesh synon individët, jo organizatat;
- ▶ **Ofensiva publike:** Paditësi përdorë mediat për të sulmuar dhe diskredituar akterët që janë pjesë e debatit publik;
- ▶ **Frikësimi dhe kërcënimi:** Paditësi ose përfaqësuesit e tij përdorin frikësime ose kërcënime ndaj atyre që janë të përfshirë në rast, në mënyrë që t'i detyrojnë ata të tërhiqen;
- ▶ **Veprime të koordinuara:** Paditësi mund të ngrit disa padi njëkohësisht ose në vende të ndryshme për të rritur presionin;
- ▶ **Refuzimi i zgjidhjes përmes mekanizmave jo gjyqësor:** Paditësi refuzon sistematikisht mundësinë e zgjidhjes së çështjes përmes mënyrave të tjera jashtë gjykatës.

Ndonëse treguesit i referohen padive civile, ato në fakt vlejnë dhe duhet të shërbejnë edhe për rastet penale siç janë kallëzimet penale apo zhvillimi i procedurave administrative për të penguar pjesëmarrjen publike.

Për tu konsideruar një veprim ligjor si SLAPP nuk kërkohet që të jenë të pranishëm të gjithë këta tregues, por sa më shumë prej tyre që janë të pranishëm ose sa më të rënda janë veprimet, aq më e mundshme është që të njëjtat të konsiderohen si një SLAPP.

2 Treguesit janë përkthyer nga Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) dhe janë përshtatur për kontekstin e Kosovës.

Cilat janë efektet e padive SLAPP?

Paditë SLAPP drejtpërdrejt dëmtojnë lirinë e shprehjes dhe pengojnë pjesëmarrjen publike. Këto lloj veprimesh, të cilat shpesh kanë për qëllim të intimidojnë dhe të frikësojnë individët ose organizatat që angazhohen në debate dhe diskutime publike, krijojnë një atmosferë ku individët hezitojnë të shprehin mendimet dhe opinionet e tyre për çështje të rëndësishme. Ky fenomen ka pasoja të rënda për demokracinë dhe për shoqëritë pluraliste, duke sjellë një kufizim të mundshëm të mundësive për përhapjen e informacionit dhe ideve.

Disa nga efektet kryesore të padive SLAPP janë të paraqitura më poshtë:

- ▀ **Kostoja financiare:** Një nga efektet kryesore që shkaktojnë paditë SLAPP është imponimi i një barre financiare mbi të paditurit. Edhe pse këto padi nuk kanë bazë të fortë ligjore, kostoja e përbaljes me to mund të çojë në falimentim ose dorëheqje të të paditurit nga ndjekja e mëtejshme e kauzave publike. Pra, paditësit përmes padive SLAPP nuk synojnë t'a fitojnë çështjen në gjykatë, por të shkaktojnë barrë të rëndë financiare mbi të paditurit, duke i detyruar ata të tërhiqen nga debati publik.
- ▀ **Presioni psikologjik:** Një ndër pasojat tjera të padive SLAPP është presioni psikologjik që u ushtrohet të paditurve. Individët që përballen me këto padi shpesh ndihen të frikësuar, të izoluar dhe të paaftë për të vazhduar angazhimin e tyre në çështjet e interesit publik. Në shumë raste, këto padi shoqërohen me kërcënime të tjera, si sulme ndaj integritetit profesional ose personal, duke krijuar një efekt frikësues mbi të gjithë ata që shprehen publikisht.
- ▀ **Dëmtimi i reputacionit:** Të paditurit nga këto padi shpesh përballen me stigmatizim publik, duke u paraqitur si persona që përhapin informacione të rreme. Edhe kur padia është e pabazuar dhe përfundimisht hidhet poshtë nga gjykata, dëmi ndaj reputacionit mund të jetë i vazhdueshëm dhe i vështirë për t'u rikuperuar. Përveç këtyre, paditë e tilla kanë edhe efekt dekurajues, duke ndikuar që shumë individë dhe organizata të heqin dorë nga aktivizmi dhe nga denoncimi i shkeljeve.

Paditë SLAPP nuk kanë vetëm efekte të menjëhershme, por edhe ndikime afatgjata në lirinë e shprehjes dhe angazhimin qytetar. Frika e përpalljes me një proces gjyqësor të lodhshëm dhe të kushtueshëm çon në vetë censurë, ku individët dhe organizatat shmangin çështjet e ndjeshme ose kufizojnë fushën e raportimeve të tyre për të mos rënë në shënjestër të akterëve të fuqishëm.

Për të luftuar efektet negative të padive SLAPP, shumë vende kanë miratuar legjislacion kundër tyre, duke përfshirë ligje që mundësojnë hedhjen poshtë të këtyre padive në faza të hershme dhe parashikojnë dënime për ata që i përdorin ato në mënyrë abuzive. Megjithatë, nevoja për mbrojtje më të forta ligjore dhe ndërgjegjësim publik për këtë problem mbetet një sfidë e rëndësishme për garantimin e të drejtës së shprehjes dhe pjesëmarrjes publike.

4. Çfarë mund të bëjnë gjykatat, prokuroritë dhe organet administrative për luftimin e padive SLAPP?

Në rastet e padive SLAPP, gjykatat, prokuroritë dhe organet administrative kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar që sistemi ligjor të mos keqpërdoret për të frikësuar ose ndaluar individët dhe organizatat që angazhohen në diskutime publike. Ky proces kërkon një trajtim dhe vëmendje të veçantë për të parandaluar abuzimin.

Në rastet civile SLAPP, kur përdoren padi civile, veprimi kryesor që mund të merret nga ana e gjykatave është:

→ **Refuzimi i padisë SLAPP si e pathemeltë në fazën e hershme:** Gjykatat duhet të kenë mundësinë të identifikojnë dhe të bëjnë refuzimin e padisë SLAPP si të pathemeltë, *bazuar në treguesit e mësipërm*, në fazën më të hershme të mundshme të procedurës pasi të shqyrtohet kërkesa dhe të vlerësohet se ajo është e pabazuar.

Refuzimi në fjalë kërkon ndryshime ligjore, megjithatë gjykatat mund të trajtojnë këto lëndë me prioritet brenda mundësive kohore për të zvogëluar dëmin ndaj pjesëmarrjes publike.

Në rastet penale SLAPP, kur ushtrohen kallëzime penale që targetojnë pjesëmarrjen publike, veprimi kryesor që mund të merret nga ana e prokurorëve është:

→ **Hedhja poshtë e kallëzimeve penale abuzive dhe mosinicimi i hetimeve:** Prokurorët mund të përdorin *treguesit e lartëpërmendur* për të identifikuar kallëzimet penale të cilat bëhen me qëllim të frikësimit dhe ndalimit të pjesëmarrjes publike në fazë të hershme dhe të mos mundësojnë inicimin e hetimeve pa bazë të fortë faktike.

Në rastet administrative SLAPP, kur kemi të bëjmë me organet administrative, veprimi kryesor që mund të merret nga ana e organeve administrative është:

→ **Ndalimi i abuzimit me procedura administrative:** Organet administrative të shtetit mund të përdorin *treguesit e lartpërmendur* për të identifikuar veprimet që bëhen me qëllim të abuzimit me procedura administrative për të penguar pjesëmarrjen publike. Duhet treguar kujdes të veçantë sidomos në situata kur ligji administrativ përdoret për raste të pjesëmarrjes publike që mund të ndërlidhet me gazetari, aktivizëm apo ndonjë fushë tjetër më interes të përgjithshëm.

Ndërmarrja e këtyre veprimeve është e rëndësishme për të parandaluar që të paditurit të përballen me procese të gjata dhe të kushtueshme që kanë si qëllim vetëm të frikësojnë dhe ndalojnë angazhimin e tyre në debatet publike. Njëkohësisht, ndërmarrja e këtyre veprimeve nga organet gjegjëse ndihmon që të sigurohet që proceset gjyqësore të mos shfrytëzohen për qëllime intimidimi, por për mbrojtjen e të drejtave të ligjshme.

5. Përfundimi

Si përfundim, ky udhëzues ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin dhe të ofrojë udhëzime praktike për autoritetet ligjore, gjykatat dhe prokuroritë në identifikimin dhe luftimin e padive SLAPP. Duke u mbështetur në Rekomandimin i KiE-së kundër Padive SLAPP dhe Direktivën e BE-së kundër padive SLAPP, ky material ndihmon në theksimin e rrezikut që këto veprime ligjore paraqesin për lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen publike. Përmes përdorimit të indikatorëve të përcaktuar, autoritetet ligjore mund të identifikojnë dhe trajtojnë paditë SLAPP në mënyrë efektive, duke parandaluar abuzime që mund të minojnë proceset demokratike dhe të drejtat e individëve.

Mbrojtja nga paditë SLAPP kërkon ndërgjegjësim dhe veprime konkrete nga gjykatat, prokuroritë dhe avokatët për të siguruar një sistem të drejtë dhe transparent, duke garantuar një mjedis të sigurt dhe të hapur për debat dhe pjesëmarrje publike. Në këtë kuadër, është e rëndësishme që strategjitë kundër SLAPP të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të individëve dhe grupeve të prekura, duke siguruar qasje të barabartë në mbrojtje ligjore. Krijimi i mekanizmave më të efektshëm për të adresuar pasojat e këtyre padive do të ndihmojë në forcimin e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e pjesëmarrjes publike për të gjithë.



British Embassy
Pristina